



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.782/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada - Gillogjani anëtar, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Anita Peci, duke vendosur përkritazi me apelin e parashtruar nga Kushtrim Krasniqi kandidatë për anëtarë për Kuvendin Komunal në Klinë nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Klinë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarë të Kuvendit Komunalë, të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET si i bazuar apeli i parashtruar nga Kushtrim Krasniqi kandidatë për anëtarë për Kuvendin Komunal në Klinë nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Klinë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarë të Kuvendit Komunalë, të mbajtura më datë 22.10.2017.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj të gjitha fletëvotimet për kandidatin Kushtrim Krasniqi nga subjekti politik LDK, në Vendvotimet: 0811C/01R, 0811C/03D, 0814C/03D, 0814C/02R, 0814C/01R, 0804C/02R, 0816C/1R.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në Vendvotimet si në pikën **II**- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 09.11.2017 ka pranuar një apel nga Kushtrim Krasniqi kandidatë për anëtarë për Kuvendin Komunal në Klinë nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Klinë, me të cilin ka theksuar se në Vendvotimin: 0811C/01R do të duhet ti ketë 4 vota ndërsa i janë shënuar 0 vota, në vendvotimin 0811C/03D ka 3 vota ndërsa do të duhet ti ketë 8 vota. Më tej parashtruesi i ankesës ka theksuar se në vendvotimet 0814C/03D, 0814C/02R, 0814C/01R e kanë votuar atë familjar të tij do të duhet te ketë 8 vota mirëpo nga rezultati shihet se i posedon vetëm 3 vota. Në vendvotimin 0804C/02R ku

po ashtu kanë votuar familjarët e tij, thekson se duhet ti ketë 4 vota ndërsa e posedon vetëm një votë. Në vendvotimin 0816C/1R po ashtu potencon se e kanë votuar familjar të tij dhe se do të duhet ti ketë 9 vota ndërsa në formularët e rezultatit përfundimtar ka zero (0) vota.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i shqyrtoi pretendimet ankimore dhe shkresat e tjera si dhe pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

Apeli është i bazuar

Paneli gjeti se pretendimet ankimore të apeluesit janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, ka konstatuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit, andaj mbi këtë baze dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatin Kushtrim Krasniqi nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) në vendvotimet e cekura në pikën dy të vendimit dhe rezultati i dalë pas rinumërimit të fletvotimeve në vendvotimet, të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të datës 22.10.2017.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura si në pikën II të dispozitivit.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.A.nr.782/2017 me datën 12.11.2017



Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.